

LIGJ
Nr. 95/2013

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË LICENCËS PËR LOTARINË KOMBËTARE
NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE, SI AUTORITET I AUTORIZUAR, DHE
SHOQËRISË “OESTERREICHISCHE LOTTERIEN”, GMBH, NËPËRMJET SHOQËRISË
“OLG PROJECT” SHPK

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet marrëveshja e licencës për lotarinë kombëtare ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet i autorizuar, dhe shoqërisë “Oesterreichische Lotterien”, GmbH, nëpërmjet shoqërisë “OLG Project”, sh.p.k.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.3.2013

Shpallur me dekretin nr. 8059, datë 15.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË NËPËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE
OESTERREICHISCHE LOTTERIEN GMBH NËPËRMJET OLG PROJECT SHPK

MARRËVESHJE LICENCE
PËR “LOTARIA KOMBËTARE”

1. Palët

Kjo marrëveshje licence për “Lotarinë kombëtare” nënshkruhet sot, më 17.12.2012], në Tiranë, Shqipëri,

ndërmjet palëve:

a) Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe institucionet në varësi të saj, emëruar në përputhje me vendimin, sikurse përshkruhet më poshtë, me adresë: bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Shqipëri, referuar së bashku si “Ministria”; dhe

b) Oesterreichische Lotterien GmbH (fituesi i tenderit), nëpërmjet kompanisë OLG Project sh.p.k. pjesë të grupit, kontrolluar plotësisht, direkt apo indirekt nga fituesi i tenderit (i licencuari), një kompani e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me seli qendrore në Tiranë, Shqipëri dhe adresë: rr. “Murat Toptani”, Eurocol Centre, kati IV, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me NIPT L22119005R.

Secila, si Ministria, ashtu edhe i licencuari referohen si “Palë” dhe në mënyrë të përbashkët si “Palët”.

Baza ligjore:

a) Ligji nr. 10 033, datë 12.12.2008 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sikundër është në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje (akti);

b) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 11.1.2012 (vendimi).

Të dyja Palët kanë zotësinë, kompetencën dhe autoritetin e nevojshëm për të lidhur këtë Marrëveshje detyruese, të zbatueshme prej secilës prej tyre sipas kushteve të përcaktuara këtu.

2. Të përgjithshme

2.1 Ministria organizoi konkurrimin (konkurrim) për dhënien e licencës ekskluzive (licencën) për ushtrimin e lotarisë kombëtare (lotaria kombëtare), duke i dhënë të drejtë ekskluzive të licencuarit për të kryer lojërat e lotarisë kombëtare, sikurse përcaktohet në nenin 26 (2) të aktit, në ditën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje (Lojërat e lotarisë kombëtare) dhe ka pranuar një aplikim nga fituesi i tenderit, sipas konkurrit. Fituesi i tenderit u përzgjedh si aplikant fitues dhe ka pranuar të ushtrojë lotarinë kombëtare sipas kësaj marrëveshjeje nëpërmjet të licencuarit. Ministria pranon që i licencuari është themeluar në përputhje me aktin për të ushtruar lotarinë kombëtare. Që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji që miraton këtë kontratë, i licencuari mban një licencë të vlefshme të lëshuar nga Ministria sipas ligjit.

2.2 Integriteti dhe siguria e lotarisë kombëtare nuk duhet të kenë vërejtje, por duhet të kenë kontrolle të rrepta për të siguruar që të gjitha aspektet e lotarisë kombëtare të jenë të sigurta, transparente, të drejta dhe të ndershme.

2.3 Si pjesë e veprimtarisë së saj rregullatore dhe konformitetit, Ministria do të kryejë një audit vjetor të gjendjes financiare të lotarisë kombëtare, të aktiviteteve dhe sistemeve kyçe të saj, dhe në çdo kohë kur çmohet e arsyeshme, për të siguruar që lotaria është financiarisht e qëndrueshme dhe funksionon me standardet më të larta dhe pa defekt, mashtrim dhe manipulim. Kujdes i veçantë do t’i kushtohet përllogaritjes për shitjet dhe alokimin e të ardhurave nga çmimet.

2.4 Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, palët përcaktojnë kushtet e bashkëpunimit të tyre në përputhje të plotë me kuadrin ligjor shqiptar, duke përcaktuar më poshtë dispozitat e ligjit në lidhje me lotarinë kombëtare.

2.5 Në rast dhe vetëm si masë e ndonjë konflikti mes kësaj marrëveshjeje, licencës, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 25 (datë 11.1.2012, “Vendimi”), ftesës për ofertë (datë 21.5.2012, “FPO”), shpjegimet e Ministrisë për pyetjet në lidhje me konkursin ose aplikimin e të licencuarit në përgjigje të FPO-së, konflikti do të zgjidhet në përputhje me rendin e mëposhtëm të përparësisë:

a) Kjo marrëveshje/licenca;

b) Akti;

c) Vendimi (në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje);

d) Aplikimi i të licencuarit, duke përfshirë shtojcat (dorëzimi);

e) Sqarimet e Ministrisë për pyetjet mbi konkursin;

f) FPO dhe qartësime, si dhe shtesat për FPO.

Për shmangien e dyshimeve, dokumentet nga “b” në “f” të kësaj klauzole 2.5, janë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.

Për shmangien e dyshimit, rendi i mësipërm i përparësisë do të zgjidhet vetëm konfliktet e mundshme të lindura nga çështjet e rregulluara në këtë marrëveshjeje, të cilat nuk përbëjnë shkelje të dispozitave ekzistuese të aktit.

2.6 Të gjitha veprimet që duhet të kryhen nga i licencuari në lidhje me këtë marrëveshje, do të kryhen me kostot e të licencuarit, përveçse kur specifikohet shprehimisht ndryshe në këtë marrëveshje.

3. Bashkëpunimi

3.1 Palët zotohen që të bashkëpunojnë në çdo kohë me njëra-tjetrën në mirëbesim, të kryejnë të gjitha aktet dhe të ndërmarrin të gjithë hapat sipas mundësisë dhe të nevojshme për ose sipas rastit për vënien në fuqi, ose ruajtjen e kushteve dhe termave të kësaj marrëveshjeje.

3.2 Në ngritjen e kërkesave, në përgjigje të çdo dorëzimi apo në ushtrimin e çdo lirie veprimi, apo të drejte të dhënë brenda termave të kësaj marrëveshjeje, palët gjithmonë duhet të veprojnë në mënyrë të

arsyeshme dhe në përputhje me ligjin. Asnjëra palë nuk do të mbajë ose nuk do të vonojë pa arsye miratimin e akteve apo kërkesave të palës tjetër, për të cilën është i nevojshëm ose i dëshirueshëm miratimi. Miratimi nga secila palë do të konsiderohet si i dhënë nëse aprovohet ose refuzohet me shkrim brenda 45 (dyzet e pesë) ditësh kalendarike nga marrja e kësaj kërkesë me shkrim të palës tjetër, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë marrëveshje. Ministria do të emërojë një person, tek i cili i licencuari mund t'i paraqesë kërkesat e tij sipas kësaj marrëveshjeje, licencës dhe aktit.

3.3 Ministria dhe i licencuari do të ngrenë një bord monitorimi, të përbërë nga tre persona nga secila palë. Ky bord do të takohet rregullisht për të shqyrtuar problemet e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

4. Kërkesat rregullatore

4.1 I licencuari është person juridik, i themeluar në mënyrë të rregullt ligjore dhe i organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe me objekt të aktivitetit, ushtrimin e lotarisë kombëtare gjatë gjithë afatit të kësaj marrëveshjeje.

4.2 Kapitali themeltar i të licencuarit duhet të jetë, të paktën, 1,200,000,000 (një miliard e dyqind milionë lekë), për të garantuar që i licencuari të jetë dhe të mbetet në gjendje të ushtrojë lotarinë kombëtare në një mënyrë të qëndrueshme financiare.

4.3 Objektivat kryesorë të të licencuarit, në bazë të kësaj marrëveshjeje, janë:

- a) të ofrojë një gamë tërheqëse lojërash të lotarisë kombëtare për tregun shqiptar të lotarisë, t'i zhvillojë ato në mënyrë të vazhdueshme dhe t'i tregojë me përgjegjshmëri;
- b) të zhvillojë tregun shqiptar të lotarisë në mënyrë të qëndrueshme dhe të përgjegjshme;
- c) të kryejë dhe të ushtrojë lojërat e lotarisë kombëtare (të gjitha ose pjesërisht) në një mënyrë të sigurt, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, si dhe duke respektuar objektivat rregullatorë; dhe

d) të arrijë një nivel të lartë të mbrojtjes së lojtarit nëpërmjet masave të duhura mbrojtëse dhe profesionale.

5. Afati dhe qëllimi

5.1 Kjo marrëveshje lidhet dhe licenca lëshohet për një periudhë që fillon nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe do të jetë në fuqi për 10 (dhjetë) vjet nga data kur hyn në fuqi miratimi nga Kuvendi i licencës dhe marrëveshjes së licencës, pas publikimit në Fletoren Zyrtare. Kjo marrëveshje nuk mund të shtyhet ose të rinovohet, përveçse kur përcaktohet ndryshe nga Ministria, me zgjedhjen e saj të plotë dhe absolute dhe pas njoftimit të duhur të të licencuarit.

5.2 Ministria, me zgjedhjen absolute të saj, mund t'i kërkojë të licencuarit të vijojë ushtrimin e lotarisë kombëtare, sipas termave të caktuar në këtë marrëveshje, duke shtyrë kohëzgjatjen e afatit të kësaj marrëveshjeje ose çdo rinovim, me anë të një njoftimi 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara, për një periudhë 6-mujore (gjashtëmujore) (periudha e shtyrjes emergjente).

5.3 Në rast se Ministria zgjat periudhën e kësaj marrëveshjeje me një periudhë shtyrjeje emergjente dhe i licencuari pëson kosto apo shpenzime mbi dhe përtej atyre që ka pasur përpara zgjatjes së kësaj marrëveshjeje, atëherë, në rast se këto kosto janë të arsyeshme e të kryera si duhet, por dhe të evidentuara në mënyrë të arsyeshme me shkrim nga një palë e tretë, auditor i licencuar i miratuar bashkërisht, në bazë të librit kontabël të hapur, kjo provë dhe informacioni i mëvonshëm që lidhet me informacionin që i është dhënë ministrisë nga i licencuari, sipas kërkesës, rimbursimi i këtyre kostove apo shpenzimeve do të kryhet nga ministria.

5.4 Republika e Shqipërisë i garanton të licencuarit se gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje, i licencuari do të zotërojë monopolin e lojërave të lotarisë kombëtare. Veçanërisht, gjatë afatit të kësaj marrëveshjeje, i licencuari do të ketë të drejtë në mënyrë ekskluzive dhe të përvokueshme të krijojë, të prodhojë, të ofrojë, të ushtrojë, të qarkullojë, të promovojë dhe të menaxhojë lojërat e lotarisë kombëtare, sikurse përcaktohet në nenin nr. 26 (2) dhe nenin nr. 8.2 të aktit, në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

5.5 Për këtë arsye, Republika e Shqipërisë garanton dhe pranon se:

- a) as nuk do të krijojë me ligj apo me mënyra të tjera, dhe as do të lejojë asnjë lojë të lotarisë kombëtare, lojë shtesë, të ngjashme apo tjetër që të ushtrohet gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje;
- b) nuk do të japë asnjë licencë tjetër lidhur me ndonjë lojë të lotarisë kombëtare, shtesë, të

ngjashme apo tjetër nga momenti kur kjo licencë të hyjë në fuqi e gjatë gjithë afatit të kësaj marrëveshjeje;

c) nuk do të lejojë apo tolerojë asnjë person tjetër juridik, person, autoritet apo agjenci të cilitdo lloji, të autorizuar tani, apo që do të autorizohet në të ardhmen për lojërat e fatit siç janë bastet sportive, bastet e garave, kazinotë, kazinotë elektronike, bingot tradicionale, bingot televizive, në përputhje me nenin nr. 5 të aktit ose lloje të tjera lojërash fati që të krijojë, të prodhojë, të ofrojë, të ushtrojë, të qarkullojë, të promovojë ose të menaxhojë ndonjë lojë shtesë të ngjashme apo lojëra të tjera të lojërave të lotarisë kombëtare;

d) nuk do të ushtrojë vetë ndonjë lojë shtesë, të ngjashme apo lojë tjetër të lojërave të lotarisë kombëtare gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje;

e) nuk do të revokojë, do të anulojë, do të përfundojë, do të modifikojë, do të ndryshojë, do të kufizojë apo do të pezullojë plotësisht ose pjesërisht licencën ose këtë marrëveshje, fushën dhe kohëzgjatjen e saj, për asnjë arsye tjetër veç atyre të dhëna shprehimisht në këtë marrëveshje.

5.6 I licencuari ka të drejtë, por nuk është i detyruar, të krijojë, të prodhojë, të ofrojë, të ushtrojë, të qarkullojë, të promovojë dhe të menaxhojë të gjitha lojërat e lotarisë kombëtare. I licencuari nuk do të humbë asnjë nga të drejtat e tij të kësaj marrëveshjeje për të krijuar, për të prodhuar, për të ofruar, për të ushtruar, për të qarkulluar, për të promovuar ose për të menaxhuar çdo lojë të lotarisë kombëtare, nëse ajo nuk ofrohet në asnjë kohë ose për disa kohë gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje.

5.7 I licencuari do të ketë të drejtë ekskluzive dhe do të jetë i autorizuar të përdorë pa pagesë termin “Lotaria kombëtare”, si dhe çdo emër tjetër tregtar që e sheh të nevojshëm për ushtrimin e lotarisë kombëtare gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje. Për të shmangur dyshimet, emri tregtar përfundimtar i përdorur për lotarinë kombëtare do të kërkojë aprovim paraprak me shkrim nga Ministria; miratim i cili nuk duhet të pengohet apo të vonohet pa arsye.

5.8 Termi “Lotaria kombëtare”, si dhe çdo emër tjetër tregtar për të cilin mund të bihet dakord herë pas here, sipas pikës 5.7 më sipër, do t’i përkasin ministrisë.

6. Hedhja në treg e lotarisë kombëtare

6.1 I licencuari do të bëjë përpjekjet më të mira për të siguruar që lotaria kombëtare të jetë funksionale 8 (tetë) muaj pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, por në çdo rast, jo më parë sesa 4 (katër) muaj pas datës në të cilën ka hyrë në fuqi miratimi nga Kuvendi i marrëveshjes së licencës, pas publikimit në Fletoren Zyrtare, ku i licencuari, të paktën do të ketë hedhur në treg një lojë të lotarisë kombëtare.

6.2 I licencuari nuk do të mbajë përgjegjësi sa i përket ndonjë vonese lidhur me hedhjen në treg në kohën e duhur të lotarisë kombëtare ose ndërprerjen në çdo aspekt, të vijueshmërisë së ushtrimit të lotarisë kombëtare, kur kjo vonesë është shkaktuar nga mosmarrja nga Republika e Shqipërisë e informacionit, asistencës apo miratimeve të kërkuara për t’i mundësuar të licencuarit implementimin e lotarisë kombëtare dhe për të kryer përgjegjësitë e saj sipas kësaj marrëveshjeje.

6.3 Në hedhjen në treg të lotarisë kombëtare, i licencuari do të ndjekë dispozitat e dorëzimit. Çdo devijim material prej më shumë se 10% (pozitive apo negative) nga dorëzimi, i cili i atribuohet vetëm të licencuarit, do të kërkojë miratimin e Ministrisë, i cili nuk duhet të pengohet apo të vonohet pa arsye.

7. Lojërat e lotarisë kombëtare

7.1 Pjesëmarrja e lojtarëve në lojëra dhe pagesat e çmimeve do të mbetet anonime. I licencuari duhet të kryejë një regjistrim të lojtarëve (skema e regjistrimit), në rast se pjesëmarrja e lojtarëve në lojërat e lotarisë dhe në çdo lloj loje fati të ofruar, sikurse përcaktohet në nenin 26.2 Ç. iii dhe 8.2 të aktit, ku lojtarët marrin pjesë në mënyrë direkte, duke përdorur median elektronike dhe vendimi për fitimin ose humbjen, bëhet në nivel qendror dhe jepet nëpërmjet mediave elektronike.

7.2 Në rast se i licencuari ushtron skemën e regjistrimit, nuk do ta tarifojë lojtarin për regjistrim, përveçse kur tarifa e propozuar aprovohet nga Ministria.

7.3 Skema e regjistrimit nënkupton një skemë, ku:

a) një pjesëmarrës mund të regjistrojë emrin e tij/saj, adresën, detajet e llogarisë së tij/saj bankare; dhe

b) çdo çmim paguhet direkt në portofolin e tij/saj virtual, pa qenë nevoja që lojtari fitues të bëjë ndonjë komunikim për të mundësuar marrjen e çmimit të tij.

7.4 I licencuari nuk do të kryejë asnjë aktivitet tjetër, përveçse:

a) krijimit, prodhimit, ofrimit, ushtrimit, qarkullimit, promovimit dhe menaxhimit të lojërave të lotarisë kombëtare në përputhje me këtë marrëveshje;

b) aktiviteteve ndihmëse të pandaluara shprehimisht nga legjislacioni shqiptar lidhur me “Lotarinë kombëtare”, siç janë shërbimet e konsulencës, në lidhje me të cilat Ministria ka dhënë miratimin e saj paraprak me shkrim, miratim i cili nuk duhet të pengohet apo vonohet pa arsye;

c) organizimit të lotarive jashtë Republikës së Shqipërisë;

d) çdo lojë tjetër fati, sipas miratimit të njësisë së mbikëqyrjes së lojërave të fatit dhe kërkesave të licencimit të lojës specifike, miratim i cili nuk duhet të pengohet ose të vonohet pa arsye.

e) zotërimi i çdo interesi të një shoqëri e cila është shoqëri e varur/kontrolluar nga të licencuarit dhe që nuk ndërmerr asnjë aktivitet tjetër, përveç atyre të ushtruara më sipër, në Republikën e Shqipërisë, ose jashtë saj.

7.5 Në bazë të detyrimeve të tij të përcaktuara në këtë marrëveshjeje, i licencuari, gjatë afatit të licencës, do të ketë kontroll të plotë të ushtrimit dhe të menaxhimit të lotarisë kombëtare, duke përfshirë, por pa kufizuar në: furnizimin, shpërndarjen, shitjen me pakicë, marketingun, reklamimin, numrat, organizimet dhe çdo lloj loje të ofruar nën lotarinë kombëtare, dizajnin e lojës, kohën e hedhjes në treg të lotarisë kombëtare, hedhjen e shortit, shfaqjet televizive dhe çdo aktiviteti tjetër tregtar, teknik, teknologjik dhe strategjik.

7.6 Të paktën dy muaj përpara organizimit të çdo loje të lotarisë kombëtare, i licencuari duhet t'i dorëzojë njësisë së monitorimit të lojërave të fatit, kërkesën për organizimin e një loje specifike, duke përfshirë dokumentacionin e përcaktuar në nenin 11 të aktit.

7.7 Nëse Ministria dhe/ose njësia e mbikëqyrjes të lojërave të fatit kërkon sqarime të mëtejshme mbi lojën, i licencuari ftohet të dorëzojë informacion shtesë. Njësia e monitorimit të lojërave të fatit jep vendimin për të licencuarin që do të lejohet të organizojë këtë lojë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dorëzimi i dokumentacionit të të licencuarit. Ky miratim nuk duhet të pengohet ose vonohet pa arsye.

7.8 Në përputhje me nenin 13.2 të aktit dhe të udhëzimit nr. 8 të Ministrit të Financave, datë 26.1.2009, të ndryshuar, të gjitha biletat e lojës së lotarisë kombëtare dhe format e tjera të pjesëmarrjes do të kërkojnë miratimin paraprak të ministrisë dhe do të printohen/shtypen në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1497, datë 19.11.2008. Këtu pranohet shprehimisht se në përputhje me vendimin e sipërpërmendur, në rast se institucionet e përcaktuara të printimeve/shtypjes nuk kanë kapacitet teknologjik të prodhojnë biletat dhe format e tjera të pjesëmarrjes, të kërkuara nga i licencuari, atëherë i licencuari lejohet t'i printojë/shtypë biletat në një institucion që zgjedh vetë, brenda ose jashtë Shqipërisë, ndonëse me kusht që këto bileta të kenë aprovimin paraprak të Ministrisë, në përputhje me pikën 7.8 dhe nenin 13.2 të aktit. Ky miratim nuk duhet të pengohet apo të vonohet pa arsye. Për të shmangur dyshimet, për qëllimet e kësaj pike, fjala biletë nuk do të nënkuptojë kuponët termalë të letrës së printuar/shtypur nga терминаlet e shitjes me pakicë të lotarisë.

8. Pjesëmarrja në lojërat e lotarisë kombëtare, pagesat për fituesit

8.1 Pjesëmarrja në lojërat e lotarisë kombëtare është e mundshme vetëm sipas rregullores së lojës (rregullat). Rregullat dhe çdo ndryshim thelbësor duhet të përcaktohen nga i licencuari dhe duhet të miratohen nga Ministria. Miratimi i Ministrisë nuk duhet të pengohet ose vonohet pa arsye. Lojtarët duhet të pranojnë rregulloren dhe kushtet dhe janë të detyruar t'i respektojnë ato. I licencuari nuk do të jetë përgjegjës për asnjë dëm të lojtarit për shkak të mosrespektimit prej lojtarit të këtyre rregullave dhe kushteve ose udhëzimeve që përmbahen në biletën e lotarisë kombëtare të lëshuar për pjesëmarrësit (bileta).

8.2 Republika e Shqipërisë garanton se mosha minimale për pjesëmarrjen në lojërat e lotarisë kombëtare dhe e drejta për të fituar çmim nuk do të rritet për gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje. Republika e Shqipërisë siguron më tej se nuk do të prezantojë/vendosë ndonjë masë që do të përbëjë pengesë apo do të ngrejë vështirësi në organizimin, ushtrimin dhe pjesëmarrjen e lojtarëve në lotarinë kombëtare, duke përfshirë kërkesat minimale të pagesës, sikurse përcaktohet në akt, në ditën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

8.3 I licencuari duhet të sigurojë që asnjë biletë e lotarisë kombëtare nuk do t'u jepet lojtarëve pa

pagesë ose t'u shitet lojtarëve me çmim më të ulët nga çmimi i plotë që paguhet, sipas rregullores së lojës përkatëse të lotarisë kombëtare, përveçse kur pagesa e plotë e çmimit të plotë të biletës përkatëse është bërë ose nga i licencuari, ose nga një person tjetër. Sa më sipër, nuk do të ndalojë dhënien falas të biletave nga ana e të licencuarit si pjesë e aktiviteteve të tij promocionale dhe të marketingut, me kusht që përqindja minimale e pagesës të biletave të paguhet në fondin e fitimit (sikurse përcaktohet më poshtë) nga i licencuari nga fondet e veta.

8.4 As i licencuari, as ndonjë shitës me pakicë nuk do t'u japë hua para apo paradhënie asnjë personi me qëllim kryerjen e ndonjë pagese për bileta lotarie kombëtare. I licencuari do të bëjë përpjekje të arsyeshme për t'u siguruar që të gjithë shitësit me pakicë t'i përmbahen rreptësisht kësaj pike.

8.5 Bileta e lëshuar për lojtarin do të pajiset me një kod që siguron regjistrimin e saktë të biletës dhe të dhënat përkatëse të saj në sistemin e të licencuarit, sikurse është përcaktuar në pikën 10.2 më poshtë. Të dhënat mbi biletë duhet të korrespondojnë me të dhënat e ruajtura në sistemin qendror të të licencuarit. Bileta do të shërbejë si provë e vetme për pjesëmarrjen në lojën përkatëse të lotarisë kombëtare.

8.6 Prova e vetme që përcakton nëse një lojtar gëzon të drejtën për fitimin e një çmimi, është që ky lojtar të jetë posedues i një bilete fituese.

8.7 Çmimet duhet të kërkohen deri 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike nga data e hedhjes së shortit përkatës.

8.8 I licencuari dhe/ose pikat e shitjes me pakicë kanë për detyrim të kontrollojnë vlefshmërinë e një bilete fituese në sistemin qendror të të licencuarit, përpara se të kryejnë pagesën e çmimit.

8.9 I licencuari duhet të garantojë që të gjithë pjesëmarrësit në një lojë të lotarisë kombëtare të kenë një mundësi të arsyeshme për t'u informuar nëse kanë fituar një çmim, pa shqetësime të panevojshme dhe pa kosto për pjesëmarrësit.

8.10 I licencuari duhet të garantojë që të gjitha çmimet në çdo lojë të lotarisë kombëtare të paguhen sipas dispozitave të pikës 7.1, për mbajtësin e biletës fituese, i cili ka kërkuar tërheqjen e çmimit në mënyrën e duhur, në përputhje me rregulloret e lojës përkatëse të lotarisë kombëtare.

8.11 I licencuari do të jetë përgjegjës për të gjitha biletat fituese të lëshuara nga sistemi i të licencuarit dhe të paraqitura për pagim brenda afatit kohor. Është detyra e të licencuarit që të instalojë sisteme të posaçme në përputhje me dispozitat e pikës 10 këtu, për emetimin e biletave dhe verifikimin e biletave fituese. Gjithashtu, është detyrim i të licencuarit për të mbajtur të gatshme sisteme për të trajtuar kërkesat e pasakta që mund të paraqiten për pagesa.

8.12 I licencuari duhet të përcaktojë me zgjedhjen e vet përqindjen minimale të pagesës që do të shpërndahet për çdo lojë të lotarisë kombëtare, me kusht që shuma totale e çmimeve në para apo jo në para, për fituesit e lojërave të lotarisë kombëtare, duhet të jetë të paktën 50% e shumave të luajtura (fondi i fitimit). I licencuari duhet të publikojë shumën e fondit të fitimit, si dhe shpërndarjen e tij sipas niveleve të secilit çmim dhe fondin e rregullimit, në rregullore. Për qëllime të këtij neni, shumat e luajtura nënkuptojnë shumat totale të paguara nga lojtarët për pjesëmarrjen e tyre në lojërat e lotarisë kombëtare dhe të mbledhura nga i licencuari, sikurse provohet nga sistemi.

8.13 I licencuari nuk do të jetë përgjegjës për detyrimet e taksave të pjesëmarrësve dhe të fituesve në lotarinë kombëtare. Megjithatë, në përputhje me ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat personale", të ndryshuar, të licencuarit do t'i kërkohet t'i mbajë këto shuma taksash nga pagesat përkatëse, në masën dhjetë për qind (10%) të shumave të fituara dhe do t'ia kalojë këto shuma autoriteteve përkatëse të tatimeve.

9. Rrjeti i shpërndarjes

9.1 I licencuari ka të drejtë të ofrojë lojëra të lotarisë kombëtare nëpërmjet kanaleve tokësore, interaktive të shpërndarjes dhe atyre në distancë, ndër të tjerash, nëpërmjet internetit, telefonave celularë dhe televizioneve interaktive, gjatë gjithë afatit të marrëveshjes.

9.2 I licencuari do të ofrojë një rrjet të përshtatshëm shpërndarjeje të shitjes me pakicë, i cili arrin një ekuilibër nëpërmjet maksimizimit të shpërndarjes gjeografike për të mbuluar territorin e Republikës së Shqipërisë dhe qëndrueshmërisë tregtare të lotarisë kombëtare.

9.3 I licencuari duhet të sigurojë që gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje, të ketë një sasi të

mjaftueshme pikash shitjeje në çdo prefekturë, për të mbuluar si duhet popullsinë në prefekturën përkatëse.

9.4 I licencuari duhet të informojë Ministrinë për numrin, shpërndarjen gjeografike dhe vendin e pikave të shitjeve, ku mund të blihen biletat e lotarisë kombëtare dhe të japë detaje mbi ndryshimet, nëse ka, që kanë ndodhur në 3 (tre) muajt e mëparshëm.

10 Sistemet e implementimit

10.1 Brenda 45 (dyzetepesë) ditëve kalendarike nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje, i licencuari duhet të dorëzojë në Ministri për shqyrtim dhe miratim një plan të detajuar për ndërtim dhe implementim (plani i zbatimit) të lotarisë kombëtare, në përputhje me dispozitat e dorëzimit dhe një draftmarrëveshje të nivelit të shërbimit, duke përshkruar nivelet e shërbimit ku i licencuari do të qëndrojë gjatë periudhës së licencës dhe gjobave të propozuara, që ky i fundit duhet të pësojë, nëse nivelet e shërbimit mungojnë (NSHM). Me miratimin e Ministrisë, i cili nuk duhet të pengohet apo të vonohet pa arsye, këto dokumente do të përbëjnë një pjesë integrale të marrëveshjes.

10.2 I licencuari, me kostot e tij, duhet të instalojë dhe përdorë sisteme dhe teknologji IT të përditësuara për t'u ofruar një shërbim efikas dhe të besueshëm lojtarëve dhe shitësve me pakicë, duke përfshirë një sistem kompjuterik qendror, një qendër të të dhënave primare, një qendër rikthimi të dhënash në rast fatkeqësie, terminale të shitësve me pakicë, metodat e komunikimit, sistemet mbështetëse të kërkuara për aktivitete si shpërndarja (sistemi).

10.3 I licencuari nuk do të përdorë asnjë pajisje specifike lotarie, veçse në rastet kur certifikohet dhe miratohet nga njësia e mbikëqyrjes të lojërave të fatit. Pajisja duhet të plotësojë specifikimet minimale teknike të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Nëse një lloj i veçantë pajisjeje certifikohet, të gjitha pajisjet e këtij lloji do të certifikohen. Njësia e mbikëqyrjes të lojërave të fatit nuk duhet të pengojë apo të vonojë pa arsye asnjë certifikim dhe miratim.

10.4 Ministria duhet t'i ofrojë asistencë të arsyeshme të licencuarit për kryerjen e funksioneve dhe detyrave sipas termave të kësaj marrëveshjeje.

11. Mbrojtja e konsumatorit

11.1 I licencuari duhet të garantojë që çdo biletë të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin e lojës së lotarisë kombëtare;
- b) adresën e zyrës së regjistruar ose zyrës qendrore të të licencuarit dhe emrin e të licencuarit;
- c) një deklaratë për mënyrën e respektimit të rregullave të lojërave të ofruara të lotarisë kombëtare;
- d) çmimin e biletës;
- e) shortin (shortet) për të cilin/cilët bileta është e vlefshme (në rastin e një loje me bazë shorti);
- f) që pjesëmarrja në lojën përkatëse të lotarisë kombëtare nënkupton pranimin e rregullave;
- g) metoda me të cilën mbajtësi i biletës mund të konstatojë nëse bileta është biletë fituese;
- h) periudha brenda së cilës duhen marrë çmimet.

11.2 I licencuari duhet të bëjë përpjekjet më të mira për të siguruar që dokumentet që përmbajnë informacionin e mëposhtëm, lidhur me secilën lojë të ofruar nga lotaria kombëtare, të jenë të disponueshme për të gjithë pjesëmarrësit që i kërkojnë:

- a) rregullat e secilës lojë të lotarisë kombëtare;
- b) udhëzimet mbi mënyrën e pjesëmarrjes në lojën e lotarisë kombëtare;
- c) metodat e marrjes së çdo çmimi;
- d) periudhën brenda së cilës duhen tërhequr çmimet, në përputhje me pikën 8.7;
- e) moshën minimale të personave të cilëve mund shiten bileta në një lojë të lotarisë kombëtare së bashku me një deklaratë që çmimet nuk u paguhën personave me moshë më të vogël se moshën minimale;
- f) pjesa e të ardhurave për çdo lojë të ofruar të lotarisë kombëtare që pritet të paguhet në çmime;
- g) adresa e selisë së regjistruar ose zyrës kryesore të të licencuarit dhe emri i të licencuarit; dhe
- h) një adresë nga e cila mund të merret informacioni i mëtejshëm për secilën lojë të lotarisë kombëtare dhe ku mund të depozitohen ankesat.

11.3 I licencuari duhet të implementojë masa koherente për mbrojtjen e lojtarit. Objektivat e masave duhet të përputhen me standardet ligjore në fuqi, si dhe ato të lidhura me industrinë e Shoqatës

Botërore të Lotarisë dhe/ose Lotaritë Shtetërore Europiane dhe Shoqata e Totos. Këto duhet të përfshijnë implementimin e arsyeshëm të programeve të mëposhtme të mbrojtjes së lojtarëve:

a) Reklamimi dhe marketingu i përgjegjshëm. I licencuari nuk duhet t'ua drejtojë publicitetin grupeve vulnerabël (sa i përket moshës, gjendjes sociale ose varësisë nga lojërat e fatit), por duhet të miratojë një kod reklamimi dhe marketingu (Kodi i Reklamimit) që të sigurojë që aktivitetet e reklamimit dhe të promovimit të shitjeve të mos inkurajojnë të miturit ose personat me probleme në të luajtur dhe të mos u ofrojnë lojtarëve informacion keqorientues, si p.sh. përshtypje e rreme e shanseve të fitores.

b) Për të shmangur këto efekte negative sa më mirë, i licencuari, brenda 4 (katër) muajve pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, duhet të përgatisë dhe të dorëzojë në ministri për miratim Kodin e Reklamimit.

c) Edukimin e lojtarëve, mbrojtjen e të miturve dhe parandalimin e varësisë. I licencuari duhet të përfshijë elemente në informacionin e synuar për lojtarët (duke përfshirë nëpërmjet kanaleve në distancë) që i lejon këta të fundit të vlerësojnë rreziqet dhe përfitimet e të luajturit, për shembull informacionin e detajuar mbi shanset e fitimit për secilën lojë të lotarisë kombëtare.

d) I licencuari nuk duhet t'u shesë bileta të miturve dhe do të hartojë një program për implementimin e kësaj nëpërmjet rrjetit të agjentëve të tij të shitjeve.

e) Ndërgjegjësimi i konsumatorëve duhet të rritet nëpërmjet dhënies së informacionit (p.sh. broshurave, faqes së internetit).

f) Trajnimi i punonjësve. I licencuari duhet të sigurojë për të gjithë punonjësit trajnim dhe informim mbi programin e tij të të luajturit me përgjegjësi dhe do të sigurojë që një nivel i duhur ndërgjegjësimi lidhur me të luajturit me përgjegjësi duhet të ruhet kudo në kompaninë e të licencuarit, në mënyrë që të luajturit me përgjegjësi të bëhet një pjesë integrale e aktiviteteve ditore.

g) Programet e agjentëve të shitjes. Të gjithë agjentëve të shitjes të të licencuarit do t'u ofrohen materiale trajnimi dhe informimi (p.sh. broshura), në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi i të luajturit me përgjegjësi dhe të edukohen mbi çështjet e lidhura me problemet me të luajturit. Përpara se agjentët e rinj të shitjes të lejohen të shesin produktet e të licencuarit, duhet t'u ofrohet trajnim, mes të tjerash mbi të luajturin me përgjegjësi.

h) Nëpërmjet internetit, sikurse përcaktohet nga nenet 8.2 dhe 26.2. Ç (iii) të aktit. I licencuari duhet të sigurojë që platformat përkatëse të të luajturit të kenë:

- i) sistemin e verifikimit të moshës;
- ii) kufijtë për konsumatorin për lojën, shpenzimet dhe humbjet;
- iii) mundësinë e vetëpërfshirimit për lojtarët;
- iv) kontroll real mbi ekranin e lojës (ora e sesionit, paralajmërimi në rast se janë arritur kufijtë e vetëpërcaktuar ose të përgjithshëm);
- v) kontrollet e mbrojtjes së të dhënave;
- vi) shfaqjen e vlerës së basteve; dhe
- vii) lidhjet me çdo faqe interneti për informacionin lidhur me të luajturit e lojërave të fatit me përgjegjësi dhe politikat e të licencuarit mbi të luajturit me përgjegjësi;

12. Siguria

12.1 I licencuari duhet të garantojë në mënyrë të arsyeshme sigurinë e të gjitha pajisjeve, sistemeve, programeve kompjuterike, të dhënave, biletave, materialeve të biletave dhe artikuj të tjerë të konsumueshëm që përdoren në lidhje me lojërat e lotarisë kombëtare, si dhe të gjitha paratë që vijnë nga çdo lojë e lotarisë kombëtare, në mënyrë që të minimizohen mundësitë për vjedhje, mashtrim ose keqpërdorim.

12.2 Këto masa, sipas pikës 12.1, duhet të jenë në përputhje me Standardin e Kontrollit të Sigurisë të Shoqatës Botërore të Lotarisë dhe do të përfshijnë:

a) masat për të siguruar që furnizimi, riparimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të instaluar dhe ofrimi i pjesëve të këmbimit për këto pajisje të jenë në çdo kohë nën kontrollin e të licencuarit;

b) siguri mbi prodhimin e të gjitha biletave të lotarisë kombëtare dhe artikujve të tjerë që mund të përdoren për të prodhuar bileta të falsifikuara të lotarisë kombëtare;

c) siguria e regjistrimeve të formatit elektronik dhe fizik;

- d) siguria e pajisjes së shortit dhe të procesit të shortit;
- e) siguria e shitësit me pakicë;
- f) siguria e të gjitha transaksioneve të sistemit të lotarisë;
- g) siguria mbi pagesat e çmimeve;
- h) masat për të siguruar që çdo e dhënë dhe informacion tjetër lidhur me lotarinë kombëtare nuk mund të aksesohen, lexohen, shtohen, hiqen ose ndryshohen nga personat e paautorizuar; dhe
- i) siguria dhe integriteti i sistemit IT.

12.3 Siguria e sistemit IT të të licencuarit duhet të përfshijë kontrollet e hyrjes dhe masat për të parandaluar leximin, shtimin, heqjen apo tjetërsimin e çdo informacioni nga personat e paautorizuar.

12.4 Kur është e nevojshme që një zonë (qoftë në ambientet e të licencuarit, ose të një pale tjetër; “zona e sigurt”) të mbahet e sigurt për të ruajtur sigurinë e lotarisë kombëtare, i licencuari duhet të mbajë një regjistër të personave që lejohen të hyjnë në secilën zonë të sigurt. Gjithashtu, i licencuari duhet të garantojë që të ruhet një nivel i përshtatshëm sigurie në dhe rreth zonave të sigurta.

12.5 I licencuari duhet të ushtrojë disiplinë të rreptë mbi të punësuarit e tij që kryejnë shërbimet sipas kësaj marrëveshjeje. Në këtë aspekt, i licencuari duhet të hartojë një kod sjelljeje. Brenda dy muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, i licencuari duhet t’i dorëzojë për miratim Ministrisë Kodin e Sjelljes për Lotarinë Kombëtare. I licencuari nuk duhet të tolerojë asnjë veprim të gabuar apo të pahijshëm në asnjë rast dhe kur ka shkelje të Kodit të Sjelljes, duhet të ndërmarrë masat e duhura për të korrigjuar problemin.

12.6 I licencuari nuk duhet të bëjë ofertë pune, zyrtarisht apo jozyrtarisht, në mënyrë direkte, apo indirekte ose të propozojë organizime biznesi të çfarëdolloji me çdo punonjës, drejtor, konsulent, ose çdo person apo organizatë tjetër që lidhet direkt me ministrinë dhe projektin e lotarisë kombëtare.

12.7 I licencuari duhet të garantojë që çdo person që drejton aktivitetin e të licencuarit të jetë i përshtatshëm dhe i aftë dhe të ketë kualifikimet dhe aftësitë e duhura të kërkuara për të kryer me efikasitet rolin e tij. I licencuari duhet t’i paraqesë Ministrisë një listë me përfaqësuesit e tij ligjorë, drejtorin ekzekutiv për ushtrimin e lotarisë kombëtare, drejtorëve, punonjësit e rëndësishëm dhe kjo listë duhet të rifreskohet për çdo ndryshim. Brenda dy muajve nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje, i licencuari duhet t’i dorëzojë Ministrisë skemën e përditësuar të organizimit, i cili përshkruan ekipin e projektit që do të jetë përgjegjës për implementimin e detyrave të kësaj marrëveshjeje.

12.8 I licencuari nuk duhet të përdorë emrin, logon, ose imazhe të Ministrisë, apo informacion tjetër që rezulton nga kjo marrëveshje si pjesë e njoftimeve për media ose reklamimeve tregtare pa miratimin paraprak me shkrim të Ministrisë, miratim i cili nuk duhet të mos jepet ose vonohet pa arsye.

13. Inspektimet, informacioni dhe raportimi

13.1 I licencuari, me kostot e tij, do të ofrojë në një vend të caktuar nga Ministria 2 (dy) terminalë kompjuterikë që do të ofrojnë të drejtë hyrjeje thuajse në kohë reale vetëm për lexim të informacionit të mëposhtëm financiar të të licencuarit: shitjet e lojës, pagesën e çmimit, tatimet përkatëse dhe çdo informacion tjetër të gjendur në sistem që Ministria mund të kërkojë me arsye.

13.2 I licencuari duhet t’i ofrojë Ministrisë, në kohë të caktuara dhe në një format të përshtatshëm, informacionin përkatës që ajo mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me lotarinë kombëtare sa i përket çdo dispozite të kësaj marrëveshjeje dhe aktit.

13.3 I licencuari duhet të emërojë personat përgjegjës për përputhshmërinë ligjore dhe kuadrin rregullator në selinë e saj qendrore. Çdo informacion i kërkuar për t’iu dhënë Ministrisë sipas kësaj marrëveshjeje dhe aktit, duhet të jepet në formën që ministria mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

13.4 I licencuari, pas marrjes së një njoftimi paraprak të arsyeshëm, do t’i lejojë Ministrisë dhe përfaqësuesve të saj të drejtë hyrjeje në ambientet e të licencuarit kur është e nevojshme për t’i mundësuar Ministrisë kryerjen e inspektimeve në përputhje me këtë marrëveshje dhe aktin.

13.5 Raportimi i incidenteve

13.6 Në rast të ndonjë incidenti material të ndodhur, i cili ndikon negativisht nga ana materiale mbi funksionimin e rregullt të lotarisë kombëtare apo interesave të lojtarëve (incidenti), duke përfshirë:

- a) mashtrim;
- b) defekt material në sistemin e lojërave të fatit të pariparuar brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike;

ose

c) problem material që tregon se i licencuari nuk ka mbajtur një set të përshtatshëm regjistrash dhe regjistrimesh dhe nuk ka operuar me një sistem të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm financiar.

I licencuari:

a) duhet të njoftojë menjëherë Ministrinë për incidentin;

b) brenda një afati të arsyeshëm të specifikuar nga ministria, duhet t'i ofrojë kësaj të fundit një raport me shkrim duke i detajuar natyrën, shkakun dhe ndikimin apo ndikimin e mundshëm të incidentit, veprimin e marrë nga i licencuari për t'iu përgjigjur dhe për të minimizuar pasojat e menjëhershme apo pasuese dhe veprim të marrë ose të propozuar nga i licencuari për të siguruar që incidenti të mos ndodhë përsëri ose që rreziku i përsëritjes së tij të jetë minimizuar; dhe

c) duhet t'i lejojë Ministrisë dhe këshilluesve të saj të drejtë hyrjeje në ambientet e të licencuarit, pasi është e nevojshme t'i mundësojë Ministrisë që të vlerësojë ndikimin ose ndikimet e mundshme të incidentit dhe gjithashtu të vlerësojë nëse veprimi i marrë apo i propozuar nga i licencuari është i përshtatshëm për të siguruar funksionimin e duhur të lotarisë kombëtare apo jo.

13.7 Regjistrat

I licencuari duhet të ndërtojë dhe të mbajë të përditësuar regjistrat e mëposhtëm:

a) anëtarët e stafit të të licencuarit;

b) asete të të licencuarit me vlerë mbi 1,000,000 (një milion lekë);

c) nënkontratat (nëse ka);

d) regjistrin e Zonës së Sigurt;

e) pikat e shitjes me pakicë nga ku janë shitur biletat;

f) historikun e incidenteve; dhe

g) çdo libër ose regjistrime të tjera të kërkuara nga akti.

13.8 Informacion mbi transaksionet financiare

a) I licencuari duhet të mbajë të dhëna për çdo transaksion financiar (transaksionet financiare) në lidhje me pjesëmarrjen e lojtarëve në lojërat e lotarisë kombëtare në një formë të tillë që të mundësojë analizën e këtyre transaksioneve nga Ministria.

b) Gjithashtu, i licencuari duhet të informojë Ministrinë mbi shitjet e biletave të lotarisë kombëtare, të ndara sipas llojit të lojërave të lotarisë kombëtare, prefekturës, shitësit me pakicë dhe shpërndarjes së çmimeve sipas vlerës dhe mundësisë së fitimit të çmimeve për çdo lojë të ofruar të lotarisë kombëtare.

c) I licencuari duhet të mbajë të dhëna të transaksioneve financiare dhe të përgatisë raporte vjetore financiare për aktivitetet e tij në përputhje me legjislacionin shqiptar mbi kontabilitetin financiar.

13.9 Mbrotjtja e të dhënave personale të lojtarëve

a) I licencuari nuk duhet të bëjë publike dhe nxjerrë tek asnjë palë e tretë, identitetin e personit që ka fituar një çmim në një nga lojërat e lotarisë kombëtare, nëse ky person është i njohur për të licencuarin dhe ka kundërshtuar çdo dhënie informacioni, përveçse në rastet kur një gjë e tillë kërkohet me ligj ose nga autoritetet shqiptare të tatimeve.

b) I licencuari duhet të garantojë që asnjë reklamë e lotarisë kombëtare të mos përfshijë emrin, apo imazhe të identifikueshme të ndonjë fituesi që i është kryer pagesa e parave, pa miratimin e këtij individ.

13.10 Pa cenuar dispozitat e tjera të pikës 13, bashkëpunimi me Ministrinë do të kryhet sa më shumë të jetë e mundur nga ana praktike, sipas dispozitave të dorëzimit ose nëse ato mund të modifikohen herë pas here, do të konsultohet me Ministrinë.

14. Struktura e aksionarëve dhe transferimi i aksioneve

14.1 Çdo ndryshim që rezulton mbi 50% të kapitalit themeltar ose të të drejtave të votës së të licencuarit ose të aksionarëve direkt të tij, duhet t'i nënshtrohet miratimit paraprak me shkrim të Ministrisë, miratim ky që nuk duhet penguar ose vonuar pa arsye. Për të shmangur dyshimet, miratimi i Ministrisë nuk do të kërkohet nëse ndryshimi i kapitalit ndodh brenda kompanive të grupit të kompanive të të licencuarit (transferime të brendshme aksionesh).

14.2 Nëse i licencuari pëson një ndryshim material në kushtet e tij financiare, që mund të

shkaktojë riorganizim apo procedura të pamundësisë së pagesës gjatë afatit të kësaj marrëveshjeje, i licencuari duhet të njoftojë me shkrim Ministrinë në kohën kur ndodh ose identifikohet ndryshimi material. Mosnjoftimi i Ministrisë mbi këtë ndryshim mund të rezultojë në përfundimin e marrëveshjes.

15. Delegimi, kontraktorët

15.1 I licencuari duhet të ketë përgjegjësi të vetme për dërgimin, implementimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen tregtare dhe teknike të të gjithë produkteve dhe shërbimeve të ofruara në aplikimin dhe marrëveshjen/licencën e tij, qoftë ky apo jo prodhuesi ose fabrikuesi i tyre. Ministria do ta konsiderojë të licencuarin si pikën e vetme të kontaktit lidhur me çështjet kontraktuale. I licencuari nuk duhet t'ia kalojë marrëveshjen e licencës ose licencën asnjë pale tjetër.

15.2 Nëse i licencuari duhet të përdorë nënkontraktorë për të përmbushur të gjitha detyrimet, sipas kësaj marrëveshjeje licence, ai do të jetë plotësisht përgjegjës për performancën, përmbushjen e termave dhe kushteve të marrëveshjes së licencës dhe përmbajtjes ndaj kërkesave të të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi nga ana e nënkontraktorëve. Përveç nënkontratave të renditura në aplikim të gjitha nënkontratat duhet t'i nënshtrohen një miratimi paraprak me shkrim nga autoriteti, miratimi i të cilave nuk duhet të pengohet ose vonohet pa arsye. I licencuari është përgjegjës për informimin e nënkontraktorit lidhur me çdo detyrim kontraktual, apo detyrim tjetër të lindur nga marrëveshja e licencës me ministrinë dhe që ka lidhje me detyrat e nënkontraktorit. Aplikanti duhet të paraqesë një listë dhe detaje për përfshirjen e të gjithë nënkontraktorëve që ai propozon të përdorë në raport direkt me detyrimet sipas marrëveshjes së licencës. Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje, fjala nënkontraktor u referohet palëve të treta ofrues të të licencuarit të cilët kryejnë detyra thelbësore dhe kritike për lotarinë kombëtare, siç është instalimi dhe funksionimi i sistemit të përcaktuar në pikën 10.2.

16. Shkelja e së drejtës së autorit

16.1 I licencuari zotohet se do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur çdo shkelje të së drejtës së autorit. Shkeljet e së drejtës së autorit duhet të shmangen gjithashtu gjatë fazës së parë kur lotaria kombëtare, përfshirë të gjithë sistemet, mallrat dhe shërbimet që do të ofrohen, të jenë projektuar dhe furnizuar, si në fazat pasuese kur lotaria kombëtare të jetë ndërtuar dhe më vonë ushtruar.

16.2 Për këtë qëllim, i licencuari duhet të përpiqet që të mos kryhet asnjë shkelje e të drejtave të autorit nga ai apo punonjësit e tij.

16.3 I licencuari duhet të garantojë që të gjitha materialet e integruara në sistem, mes të tjerash, programet kompjuterike, bazat e të dhënave, fotografitë, veprat e pikturuara, veprat audio dhe video, muzika dhe përgjithësisht të gjitha veprat që përfshihen në fushën e mbrojtjes së të drejtës së autorit, të përdoren vetëm me miratimin e autorit të veprave. Përdorimi i ligjshëm dhe korrekt përfshin, nëse kërkohet, pagesën e së drejtës së përdorimit ose të riprodhimit, integrimin e emrit të autorit ose të prodhuesit, ose sikurse e kërkon ligji dhe përgjithësisht respektimi i të gjitha të drejtave morale të autorit mbi vepër.

16.4 Mënyra me të cilën ndodh shkelja e së drejtës së autorit nuk ka rëndësi dhe përfshihet në kuptimin e kësaj pike, mes të tjerash, shkeljet e bëra nga shpërndarja e veprave të mbrojtura me të drejtë autori në kontekstin e një cepi bashkëbisedimi në një faqe interneti.

16.5 I licencuari merr përsipër të gjitha përgjegjësitë dhe do ta mbrojë Republikën e Shqipërisë nga dëmet e shkaktuara nga çdo detyrim që rezulton nga shkelja e së drejtës së pronësisë intelektuale dhe të drejtës së autorit si rezultat i veprimeve me faj të të licencuarit. I licencuari nuk mund të mbrohet e as të heqë dorë nga përgjegjësitë, duke deklaruar se shkelja u krye nga një punonjës. Në rast se paditet direkt Republika e Shqipërisë nga personi apo kompania të drejtat e së cilës janë shkelur, Republika e Shqipërisë mund të njoftojë të licencuarin për të marrë pjesë në procedimet gjyqësore. I licencuari duhet të mbështesë Republikën e Shqipërisë në mbrojtje të çdo pretendimi dëmi.

16.6 I licencuari duhet të garantojë që nënkontraktorët e tij apo personat që veprojnë nën kontrollin direkt të të licencuarit do të lidhet nga një detyrim i ngjashëm për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe që çdo palë të marrë përsipër të gjitha përgjegjësitë dhe ta mbrojë Republikën e Shqipërisë nga dëmet që shkaktohen nga përgjegjësitë që rezultojnë nga shkelja e së drejtës së pronësisë intelektuale ose të drejtës së autorit si rezultat i veprimeve me faj të kësaj pale.

17. Të drejtat e pronësisë intelektuale

17.1 Në rastet kur i licencuari përdor ose mbështetet mbi të drejtat e pronës intelektuale të një pale të tretë në përmbushjen e detyrimeve të tij, sipas kësaj marrëveshjeje, i licencuari, me kërkesë të Ministrisë, duhet t'i japë asaj certifikatat e pranueshme që përdorimi i këtyre të drejtave të pronësive intelektuale të palës së tretë është i lejueshëm.

17.2 Përveç termave të renditur në pikën 5.7, për të cilat do të aplikohen dispozitat e pikës 5.8, palët bien dakord që të gjitha të drejtat e pronësive intelektuale që lidhen me çdo produkt apo shërbim të ofruar, zhvilluar nga ose për të licencuarin, qofshin këto të regjistruara apo jo, sipas kësaj marrëveshjeje janë dhe do të mbeten pronë e të licencuarit. Asgjë në këtë marrëveshje nuk do të interpretohet si dhënie për Republikën e Shqipërisë e një licence në lidhje me pronësinë intelektuale.

18. Pagesa e licencës

18.1 Pagesat sipas termave të kësaj marrëveshjeje dhe aktit do të kryhen me transfertë direkte (apo me metodë tjetër, sikurse mund ta specifikojë në mënyrë të arsyeshme me shkrim Ministria) në llogarinë bankare të specifikuar nga Ministria.

18.2 I licencuari nuk do të trajtohet ndryshe nga subjektet e tjerë në Republikën e Shqipërisë që kanë të njëjtën formë si person juridik edhe për sa u përket çështjeve tatimore dhe taksave, përveçse në rastet kur shprehet ndryshe në këtë marrëveshje ose në akt në datën e nënshkrimit të marrëveshjes dhe përveç tatimeve, taksat dhe tarifat të shoqërisë që janë të specifikuara në dispozitat e pikës 18.3.

18.3 Në përputhje me aktin, i licencuari do t'i paguajë Republikës së Shqipërisë vetëm tatimet dhe taksat e mëposhtme lidhur me ushtrimin e aktivitetit të lotarisë kombëtare gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje:

a) Një tatim të lojërave të fatit, në shumën e dhjetë për qind (10%) të xhiros së të licencuarit që rrjedh nga lojërat e lotarisë kombëtare dhe aktivitetet ndihmëse të miratuara (tatimi); dhe

b) Një tarifë për "Njësinë e mbikëqyrjes të lojërave të fatit", një person juridik publik, me seli në Tiranë në varësi të Ministrisë, e caktuar për mbikëqyrjen e lojërave të fatit, në shumën 0,5% (zero pesje pesë për qind) të xhiros së të licencuarit që rezulton nga lojërat e lotarisë kombëtare, por jo më pak se 2,000,000 (dy milionë lekë) në vit (viti i plotë) nga hedhja në treg e lojës së parë të lotarisë kombëtare (tarifa). Tarifa do të paguhet në llogarinë bankare të njësisë së mbikëqyrjes të lojërave të fatit, në katër këste, sikurse përcaktohet nga udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 47, datë 26.11.2009.

c) Një kontribut i detyrueshëm për çështjet e mira, që do të jetë 2.2% (dy pesje dy për qind) e xhiros vjetore të të licencuarit. Ky kontribut në çdo vit financiar do të paguhet nga i licencuari jo më vonë se data 15 shkurt e vitit pasardhës financiar. Një bord për çështjet e mira i përbërë nga 3 përfaqësues të të licencuarit dhe 4 përfaqësues të Ministrisë do të miratojë projektet specifike, organizatat ose eventet të cilat do të financohen nga kontributet. I licencuari mund t'i komunikojë publikut shumat dhe aktivitetet ku janë dhënë këto kontribute. Procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e projekteve, organizatave apo eventeve nga bordi i çështjeve të mira, do të përcaktohen në një vendim të Këshillit të Ministrave dhe në një udhëzim të Ministrit të Financave. I licencuari do të krijojë një njësi të veçantë për implementimin, procedurat dhe kompetencat e të cilit do të përcaktohen në detaje në vendimin në fjalë të Këshillit të Ministrave dhe në udhëzimin përkatës të Ministrit të Financave.

18.4 Lojërat e lotarisë kombëtare dhe organizimi i lotarisë kombëtare do të përjashtohen nga pagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar për kohëzgjatjen e kësaj marrëveshjeje. Për të shmangur dyshimet, aktivitetet sipas pikës 7.4, "b" dhe "e" nuk përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

18.5 Republika e Shqipërisë garanton që i licencuari nuk do të jetë i detyruar të kryejë ndonjë pagesë shtesë sigurie përtej asaj që është përcaktuar në këtë marrëveshje. Republika e Shqipërisë garanton gjithashtu se në rast të vendosjes së tarifave shtesë, taksave dhe tatimeve, apo masave të tjera të barasvlershme në lidhje me lotarinë kombëtare brenda afatit të kësaj marrëveshjeje, mbi dhe përtej atyre të përcaktuara në pikën 18.3 dhe 18.4, do të mbajë të padëmtuar të licencuarin. Për të shmangur dyshimet, kjo pikë 18.5 u referohet detyrimeve tatimore mbi lojërat e fatit, sikurse parashikohet në akt dhe jo taksave të tjera (p.sh. taksa e korporatës, taksat lokale) etj. për sa kohë që ato janë të zbatueshme për të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari tregtare në Republikën e Shqipërisë.

19. Penalitete

19.1 Sipas dispozitave të kësaj marrëveshjeje dhe licencës, pa cenuar asnjë të drejtë të saj brenda

afatit të përcaktuar këtu ose në ligj, nëse i licencuari ka dështuar materialisht ose dështon për të zbatuar një dispozitë të kësaj marrëveshjeje, Ministria, mund:

- a) të kërkojë që i licencuari të ndreqë shkeljet; dhe
- b) t'i vendosë gjobë të licencuarit dhe i ky i fundit t'ia paguajë ministrisë këtë gjobë.

19.2 Nëse Ministria pretendon se i licencuari ka dështuar materialisht në përmbushjen e një dispozite të kësaj marrëveshjeje, Ministria do të njoftojë me shkrim të licencuarin për faktin se ai ka dështuar materialisht ose është duke dështuar materialisht në zbatimin e kësaj marrëveshjeje, sipas rastit, duke deklaruar se në çfarë aspekti ka dështuar i licencuari lidhur me zbatimin e saj dhe të përcaktojë, lidhur me shkeljen, një periudhë prej 14 (katërmëdhjetë) ditësh kalendarike ose një periudhë më të gjatë kohore që Ministria mund të vendosë, brenda të cilës i licencuari duhet ta ndreqë këtë shkelje.

19.3 I licencuari, pas marrjes së këtij njoftimi, por jo përpara përfundimit të kohës së parashikuar, mund:

- a) t'i bëjë deklaratimet me shkrim Ministrisë për këtë moszbatim; dhe/ose
- b) të shfaqet përpara Ministrisë ose një komiteti të caktuar nga ministria për këtë qëllim për të bërë deklaratimet verbale në lidhje me këtë moszbatim.

19.4 I licencuari, brenda periudhës kohore të përcaktuar në njoftim, të parashikuar në nenin 19.1 dhe sipas shkeljeve të cilat mund të jenë ndrequr, duhet ta ndreqë këtë shkelje.

19.5 Ministria, nëse mendon për vendosjen e një gjobe lidhur me dështimin material të të licencuarit për moszbatim të kësaj marrëveshjeje, informon me shkrim të licencuarin, mbi këtë fakt.

19.6 Nëse Ministria ka treguar se është duke menduar vendosjen e një gjobe, i licencuari brenda një periudhe të përcaktuar nga Ministria, por jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, ose një periudhe kohore më të gjatë që mund të caktojë në mënyrë të arsyeshme Ministria, mund:

- a) t'i bëjë deklarime me shkrim Ministrisë për këtë mospërmbushje; dhe/ose
- b) të shfaqet përpara Ministrisë ose një komiteti të caktuar nga ministria për këtë qëllim, për të bërë deklarime verbale për këtë mospërmbushje.

19.7 Ministria, pas shqyrtimit të përfaqësimeve (nëse ka), duhet të marrë një vendim mbi vendosjen e një gjobe për moszbatim të marrëveshjes nga i licencuari, si dhe shumën e kësaj gjobe.

19.8 Për këtë qëllim, Ministria ose komiteti i përcaktuar nga ministria për këtë qëllim, duhet të marrë në shqyrtim të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë:

- a) aftësinë e të licencuarit që të parashikonte ose të shmangte mospërmbushjen e kësaj marrëveshjeje;
- b) nëse mospërmbushja e kësaj marrëveshjeje është rezultat i veprimit apo mosveprimit të të licencuarit;
- c) masën në të cilën i licencuari ka nxjerrë përfitim financiar nga mospërmbushja e kësaj marrëveshjeje;
- d) masën në të cilën i licencuari ka dështuar materialisht në të kaluarën për përmbushjen e kësaj marrëveshjeje;
- e) humbjen financiare të pësuar nga Republika e Shqipërisë;
- f) masën në të cilën i licencuari ka pësuar humbje financiare si rezultat i dështimit të të licencuarit në zbatimin e kësaj marrëveshjeje ose licence;

g) ndikimi dhe efekti i një gjobe mbi mundësinë e të licencuarit për të zbatuar detyrat dhe obligimet e tij ose për të zbatuar detyrimet brenda afateve të kësaj marrëveshjeje; dhe

h) faktin se i licencuari ka ndrequr shkeljen brenda periudhës së përcaktuar.

19.9 Për të shmangur dyshimet, është rënë shprehimisht dakord që:

a) Dështimi i të licencuarit për të hedhur në treg lotarinë kombëtare në datën që do të bihet dakord sipas planit të zbatimit, për shkak të arsyeve që i atribuohen vetëm të licencuarit, do t'i japë të drejtë Ministrisë të vendosë një gjobë prej 2,000,000 (dy milionë lekësh) për çdo ditë vonesë.

b) dështimi i të licencuarit për të zbatuar nivelet e shërbimit të rena dakord në NSHM do të sjellë vendosjen gjobave të përmendura në NSHM.

19.10 Një shkëputje totale sistemit të të licencuarit, që ndalon materialisht kryerjen e

transaksioneve të lotarisë, e cila ndodh brenda orëve të shitjes së biletave dhe që rregullohet brenda katër (4) orëve, nuk do të shkaktojë vënien e gjobës, ndonëse me kusht që kjo shpëputje totale të mos ketë ndodhur dy herë brenda një periudhe gjashtëmujore. Për të shmangur dyshimet, një shpëputje totale e sistemit të të licencuarit që u atribuohet shkaqeve ose palëve jashtë kontrollit direkt të të licencuarit, nuk do të shkaktojë dhënien e gjobave sipas kësaj pike.

19.11 Nëse ministria vendos të gjobisë të licencuarin, ajo do të njoftojë me shkrim të licencuarin mbi:

- a) vendimin e saj për t'i vendosur gjobë të licencuarit;
- b) shumën e gjobës që synon t'i vendosë të licencuarit; dhe
- c) datën e synuar për të specifikuar kohën kur kjo gjobë duhet t'i paguhet ministrisë nga i licencuari.

19.12 I licencuari, përpara datës në të cilën kjo gjobë duhet të paguhet, paraqitet përpara një komiteti të përcaktuar nga Ministria për këtë qëllim, për të bërë deklaratimet e drejtpërdrejta verbale mbi shumën e gjobës ose datën kur duhet të paguhet gjoba, dhe Ministria mund të rishqyrtojë vendimin e saj të mëparshëm mbi këtë aspekt.

19.13 Ministria, menjëherë pas pagesës ose likuidimit të të licencuarit për këtë gjobë, do t'i japë të licencuarit një kupon me shkrim apo vërtetime të tjera me shkrim që kjo gjobë është paguar ose likuiduar plotësisht.

19.14 I licencuari nuk do të gjobitet dy herë, në rastin kur secila nga këto gjoba të vendoset për të njëjtën shkelje të kryer nga i licencuari ose për të njëjtin shkak të veprimit; dhe në rast se mund të vendosen gjoba alternative lidhur me të njëjtën ngjarje, atëherë Ministria do të ketë të drejtë të vendosë gjobën që mund të zgjedhë.

19.15 Përgjegjësia e të licencuarit për çdo shkelje të afateve të kësaj marrëveshjeje, për sa u përket gjobave, nuk do ta tejkalojë shumën mesatare të paguar nga i licencuari në përputhje me nenin 18.3, për 6 (gjashtë) muaj kalendarike gjatë 365 ditëve kalendarike në vijim. Ministria nuk do të ketë të drejtë për dëme të tjera, përveç gjobave.

19.16 Në rast se i licencuari nuk paguan një gjobë, ose kur nuk e paguan atë brenda afatit të përcaktuar, shuma që i detyrohet do të zbritet nga pagesa e garancisë e përcaktuar në nenin 20 të kësaj marrëveshjeje.

19.17 Në rast se Ministria, mbas dështimit material të të licencuarit për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, e cila nuk ndreqet brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike mbas njoftimit paraprak të ministrisë, duke vepruar në mënyrë të arsyeshme, vendos ta pezullojë këtë marrëveshje sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje të parashikuara në pikën 22 (pezullimi dhe revokimi i licencës), atëherë Ministria, pavarësisht gjithçkaje kundër në këtë marrëveshjeje, nuk do të ketë të drejtë të vendosë gjobë për këtë moszbatim të kushteve të marrëveshjes, pas vendosjes së këtij pezullimi dhe gjatë kohëzgjatjes së tij.

19.18 Dispozitat e kësaj pike 10 nuk do të aplikohen në asnjë rast për atë çka nuk është parashikuar shprehimisht në akt dhe nuk do të jetë më pak nga sa është parashikuar në të.

20. Fondi i garancisë

20.1 I licencuari, me fondet e tij:

- a) duhet të sigurojë pagesën e çmimit të fituesve të Lojërave të Lotarisë Kombëtare;
- b) duhet të sigurojë shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore;
- c) duhet të sigurojë shlyerjen e gjobave të vendosura ndaj të licencuarit; si dhe
- d) duhet të sigurojë pagesën e detyrimeve të tjera të përcaktuara në këtë marrëveshje.

20.2 I licencuari duhet të ndërmarrë dhe t'i japë Ministrisë sigurinë e kërkuar (garancia) në mënyrë që të sigurojë pagesën e çmimit për fituesit e lojërave të lotarisë kombëtare, për secilën lojë, në përputhje me dispozitat e nenit 30 të aktit.

20.3 Forma e garancisë do të jetë një garanci bankare e përvokueshme (garancia), sikurse përcaktohet në nenin 42 të aktit dhe në udhëzimin nr. 4 të Ministrit të Financave datë 19.1.2009, në favor të Ministrisë, e vlefshme gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje. Mbas vitit të parë të aktiviteteve, vlera e sigurisë mund të modifikohet me marrëveshje të përbashkët mes palëve.

20.4 Ministria garanton se i licencuari ka paguar në favor të Ministrisë shumën prej 500.000.000 (pesëqind milionë) lekësh (tarifa e licencës).

21. Mospërbushja/shkelja

21.1 Pa rënë në kundërshtim me çka përmbahet në këtë marrëveshje, në licencë dhe në akt, i licencuari do të konsiderohet se është në mospërbushje të detyrimeve të tij nëse i licencuari:

a) nuk përmbush detyrimet materiale që lindin nga kjo marrëveshje ose akti ose është në shkelje të ndonjë detyrimi material të kësaj marrëveshjeje ose akti, dhe nëse i licencuari nuk arrin t'i ndreqë këto mospërbushje ose shkelje brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike mbas marrjes së një njoftimi me shkrim (ose një periudhe shtesë të mëtejshme sikurse Ministria mund të vendosë) të dhënë nga Ministria, me anë të të cilit i kërkon të licencuarit që ta ndreqë këtë shkelje, ose mospërbushje; ose

b) ndalon së ushtruarit aktivitet tregtar ose falimenton, ose një pjesë rrënjësore e aseteve të tij konfiskohet nga një kreditor, ose futet në procedura likuidimi përfundimtar, qoftë kjo e detyrueshme apo vullnetare; ose

c) e pranon me shkrim se nuk është në gjendje të paguajë detyrimet e tij në kohën e duhur ose nuk është në gjendje t'i paguajë ato fare; ose

d) ndonjë nga drejtorët apo administratorët e të licencuarit është dënuar për vepra penale që sipas gjykimit të Ministrisë mund të ndikojë në kapacitetin e tij profesional apo në moralin profesional dhe lidhet me aktivitetin sipas kësaj marrëveshjeje, përveçse kur zëvendësohet nga i licencuari; ose

e) ka paraqitur qëllimisht informacion të rremë gjatë fazës së kualifikimit në konkurs ose mashtron Ministrinë gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje, duke dhënë qëllimisht informacion të rremë.

21.2 Në rastin e një shkeljeje materiale nga i licencuari sipas pikës 21.1, do të zbatohen dispozitat e neneve 19 dhe 22.

21.3 Pa rënë në kundërshtim me çka përmbahet në këtë marrëveshje, në licencë dhe në akt, Republika e Shqipërisë dhe/ose Ministria do të konsiderohet si në mospërbushje të detyrimeve, nëse:

a) Ministria nuk arrin t'i përmbushë detyrimet e saj që lindin sipas nenit 5; ose

b) Ministria nuk arrin të përmbushë detyrimet e saj që lindin sipas neneve 7.1, 8.2, 8.13, 9.1, 18.2, 18.3, 18.4, 18.5, dhe 24 dhe/ose çdo detyrim tjetër material që lind nga kjo, ndonëse me kusht që Ministria nuk ka mbajtur të paprekur të licencuarin nga efektet negative të kësaj shkeljeje, në një mënyrë të rënë bashkërisht dakord mes palëve, brenda 3 (tre) muajve kalendarikë nga ndodhja e rastit të moszbatimit; ose

c) miratohen legjislacion ose rregullore, të cilat bien ndesh me termet e marrëveshjes dhe aktin në datën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje ose që kanë efekt negativ material për krijimin, prodhimin, ofrimin, ushtrimin, qarkullimin, promovimin dhe menaxhimin e lojërave të lotarisë kombëtare dhe/ose përfitueshmërinë e të licencuarit nga ushtrimi i lojërave të lotarisë kombëtare, dhe/ose aftësinë e të licencuarit për kryerjen e detyrave të tij sipas kësaj marrëveshjeje ose sipas aktit, ndonëse me kusht që ministria nuk ka mbajtur të paprekur të licencuarin nga efektet negative të këtij legjislacioni apo rregulloreje, në një mënyrë të rënë dakord bashkërisht mes palëve, brenda 3 (tre) muajve kalendarikë nga adaptimi i këtij legjislacioni apo rregulloreje.

21.4 Në rast të një shkeljeje nga ministria sipas nenit 21.3, i licencuari, me zgjedhjen e tij dhe pa përjashtuar ndonjë zgjidhje tjetër të ofruar nga ligji ose nga kjo marrëveshje, mund ta përfundojë këtë marrëveshje.

22. Pezullimi dhe revokimi i licencës

22.1 Në rast se i licencuari është duke shkelur nenin 43 të aktit, dhe/ose këtë marrëveshje, licencën sipas nenit 21.1 dhe nuk ka mundur ta zgjidhë këtë shkelje brenda 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike ose për ndonjë periudhë tjetër më të gjatë që Ministria mund të vendosë, pas marrjes së njoftimit nga Ministria, sipas dispozitave të nenit 19.2, Ministria mund ta pezullojë këtë marrëveshje.

22.2 Nëse marrëveshja pezullohet sipas dispozitave të nenit 22.11, Ministria do të përcaktojë në mënyrë të arsyeshme kërkesat që duhen plotësuar nga i licencuari për të zgjidhur shkeljen që sjell urdhrin e pezullimit. I licencuari duhet ta ndreqë shkeljen jo më vonë se (një) muaj kalendarik nga fillimi i pezullimit.

22.3 Në rast se ndodh që pas mbarimit të afatit të përcaktuar në nenin 22.2, shkelja nuk është ndrequr, nëse kjo shkelje ka nevojë të zgjidhet, ose i licencuari nuk ka arritur të përmbushë kërkesat, sikurse përcaktohen në mënyrë të arsyeshme nga ministria, për të zgjidhur problemin që shkakton urdhrin e pezullimit, atëherë Ministria mund të vijojë me përfundimin e kësaj marrëveshjeje ose me revokim të licencës.

23. Forcat madhore

23.1 Ndodhja e një force madhore (forca madhore) është një rast ose efekt që nuk mund të parashikohet ose të kontrollohet në mënyrë të arsyeshme dhe që ndodh pa fajin apo neglizhencën e palës joperformuese. Sikurse është përdorur këtu, forcë madhore nënkupton aktet e luftës, terrorizmit, veprimet e elementeve (p.sh. zjarri, përmytja, stuhia etj.), ndërprerjet e energjisë elektrike, racionimi/kufizimi, dëmtimi material, revoltat civile ose çdo kauzë tjetër e cila është përtej kontrollit të palës të prekur dhe që, edhe me ushtrimin e kujdesit të arsyeshëm, Pala në fjalë e ka të pamundur të parandalojë apo të parashikojë dhe në këtë mënyrë të planifikojë shmangien paraprake.

23.2 As i licencuari, dhe as Republika e Shqipërisë nuk do të jenë përgjegjës për ndonjë moszbatim ose vonesë në përmbushjen e çdo dispozite të kësaj marrëveshjeje, licencës ose aktit, nëse moszbatimi ose vonesa shkaktohet nga forca madhore, me kusht që ky përjashtim nga përgjegjësia të jetë i kufizuar vetëm për një periudhë të barabartë me kohëzgjatjen e forcës madhore.

24. Konfidencialiteti

24.1 “Informacion konfidencial” do të thotë informacion që në një mënyrë ose në një tjetër lidhet me lotarinë kombëtare, konkursin ose ministrinë (pavarësisht formës se si është dërguar ose në çfarë media është ruajtur), që është:

a) Informacioni që ministria njofton të licencuarin, i cili duhet të konsiderohet konfidencial; ose
b) Informacioni, natyra e të cilit nënkupton që është konfidencial ose që i është dhënë të licencuarit në rrethana që nënkuptojnë se është konfidencial, duke përfshirë informacion, zbulimi i të cilit, do të ndikonte në lotarinë kombëtare, konkursin, interesat tregtare të çdo personi, sekretet tregtare, të drejtat e pronës intelektuale dhe të gjitha të dhënat personale dhe të dhënat personale sensitive.

24.2 I licencuari nuk duhet t’i japë asnjë lloj informacioni konfidencial ndonjë pale të tretë.

24.3 Detyrimi i mësipërm lidhur me konfidencialitetin, nuk do të zbatohet për:

a) çdo lloj dhënie informacioni nga ana e të licencuarit që lejohet shprehimisht ose kërkohet nga kjo marrëveshje;

b) çdo lloj dhënie informacioni nga ana e të licencuarit që kërkohet në mënyrë të arsyeshme për ushtrimin ose zbatimin e të drejtave të veta ose për kryerjen e detyrimeve të saj sipas kësaj marrëveshjeje apo akti;

c) çdo lloj dhënie informacioni, që tashmë është në dispozicion ose është bërë publik në përgjithësi dhe është në përdorim publik, në mënyra të tjera nga rasti kur kjo ka ardhur si pasojë e ndonjë shkeljeje të ndonjë detyre ose detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit;

d) çdo lloj publikimi informacioni të nevojshëm, që mundëson një vendim në lidhje me konfliktet ose procedurat sipas aktit;

e) çdo lloj dhënie informacioni që kërkohet në bazë të ndonjë detyrimi ligjor ose juridik (përfshirë çdo urdhër të një gjykate kompetente) të vendosur mbi të licencuarin;

f) çdo lloj dhënie informacioni që tashmë është ligjërisht në zotërim të palës pritëse/marrëse, para publikimit të tij nga i licencuari;

g) çdo lloj dhënie informacioni në drejtim të këshilltarëve ose në rastin kur është propozuar se një person duhet ose mund të sigurojë fonde (direkt ose indirekt, me kredi ose me pjesëmarrje kapitali, ose formë tjetër) për të licencuarin për të bërë të mundur që ajo të kryejë detyrimet e saj sipas kësaj marrëveshjeje ose për atë person, por vetëm në masën e nevojshme në mënyrë të arsyeshme për të mundësuar marrjen e një vendimi mbi propozimin;

h) çdo lloj dhënie informacioni me qëllim:

i) shqyrtimin dhe certifikimin e llogarive të të licencuarit;

ii) kryerjen e çdo shqyrtimi nga ana e autoriteteve që kanë fuqinë e ligjit;

iii) kryerjen e çdo inspektimi nga një auditor i pavarur në përputhje me këtë marrëveshje;

iv) sigurimin e informacionit për çdo departament përkatës qeveritar ose ministror për çfarëdo qëllimi që lidhet me licencën ose lotarinë kombëtare; ose

v) çdo lloj dhënie informacioni për të cilin i licencuari merr miratimin e shprehur paraprak me shkrim të Ministrisë.

24.4 Pa rënë në kundërshtim me këtë marrëveshje, Ministria, vetëm nëse është e detyruar nga ligji (në këtë rast Ministria do të njoftojë menjëherë me shkrim të licencuarin për këtë detyrim), nën asnjë rrethanë, direkt apo indirekt, nuk do të japë ose përcjellë ndonjë palë të tretë çdo lloj informacioni konfidencial të të licencuarit, që mund t'i jetë dhënë apo siguruar nga Ministria para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe gjatë kohëzgjatjes së saj, pa lejen paraprake me shkrim të të licencuarit. "Informacioni konfidencial i të licencuarit" do të përfshijë, pa asnjë kufizim, çdo lloj informacioni me shkrim, me gojë ose të ruajtur në çdo lloj forme e pajisje elektronike, njohuritë, të dhënat, interpretimet, parashikimet, analizat, përpilimet, regjistrimet, vizatimet, përvojën, raportet, llogaritjet, studimet, shpikjet, teknologjinë, kopjet, transkriptet, sekretet tregtare, llogaritë e menaxhimit, strukturat financiare, pasqyrat financiare (audituar ose jo), marrëveshjet kontraktuale, organizimet, detajet e burimeve njerëzore dhe burimeve të tjera të të licencuarit, menaxhimin, politikat dhe procedurat, apo dokumente të tjera (të përgatitura nga i licencuari apo filialet ose këshilltarët e tij) në lidhje me të licencuarin ose filialet e tij dhe bizneset e tyre përkatëse, operacionet dhe punët në lidhje me këtë marrëveshje ose licencë, siguruar ose marrë nga Ministria, direkt ose indirekt përmes agjentëve (duke përfshirë punonjësit, zyrtarët, drejtorët dhe këshilltarët).

24.5 Pavarësisht nga sa më sipër, nuk do të konsiderohet informacion konfidencial i të licencuarit nëse një informacion i tillë tashmë është bërë i disponueshëm përgjithësisht, dhe është në dispozicion të publikut jo si pasojë e ndonjë shkeljeje të ndonjë detyre, ose detyrimi lidhur me konfidencialitetin.

25. Përfundimi

25.1 Pa rënë në kundërshtim me çka përmbahet në këtë marrëveshje, kjo marrëveshje do të përfundojë:

a) menjëherë pas përfundimit të periudhës së përcaktuar në nenin 5.1, përveç rastit kur ministria e shtyn periudhën e licencës në përputhje me dispozitat e nenit 5.2, rast në të cilin licenca do të vazhdojë të jetë në fuqi dhe me efekt të plotë deri në mbarimin e datës së përcaktuar nga Ministria, pa paralajmërim nga njëra palë për tjetrën; ose

b) në bazë të nenit 22.3; ose

c) në bazë të nenit 21.4.

cilado që ndodh më parë, por jo e kundërta.

25.2 Në rast përfundimi sipas nenit 25.1a, i licencuari:

a) Brenda 3 (tre) muajve kalendarikë pas datës (data e përfundimit) së skadimit, përfundimit, pezullimit, revokimit në përputhje me dispozitat e neneve 22.1 dhe 22.3, duhet t'i paguajë Ministrisë një shumë të barabartë me:

i) një shumë, të mjaftueshme për të paguar të gjitha çmimet në lidhje me çdo lojë të "Lotarisë kombëtare", për të cilat mund të paraqitet një pretendim i vlefshëm në datën e përfundimit, në këtë mënyrë duke shkarkuar të licencuarin nga detyrimi i tij për të paguar shpërblime të tilla; plus

ii) një shumë e cila të jetë e mjaftueshme për të paguar të gjitha çmimet që ende mund të pretendohen në lidhje me ndonjë lojë të lotarisë kombëtare, ku pjesëmarrja në të cilën ka qenë e mundur para ose në datën e përfundimit, por për shkak se fituesit e çmimeve nuk janë konstatuar në atë kohë, e në këtë mënyrë duke sjellë edhe shkarkimin e përgjegjësive të të licencuarit nga detyrimi për të paguar çmime të tilla; plus

iii) çdo shumë parash që në datën e përfundimit është bartur nga një lojë e lotarisë kombëtare, e cila është luajtur para datës së përfundimit, që përfaqëson vlerën e një çmimi që nuk ishte fituar në atë lojë të lotarisë kombëtare, me një pamje për të sikur t'i jetë shtuar shumës në dispozicion që duhet të paguhet në çmime në një lojë të lotarisë kombëtare që synohet të mbahet pas datës së përfundimit; plus

iv) çdo shumë të pranuar nga ose në emër të të licencuarit nëpërmjet pagesave paradhënie ose pagesave të abonimit për çdo lojë të lotarisë kombëtare, datë e tërheqjes së të cilave do të binte pas datës së licencës.

b) Në ndonjë kohë kur Ministria mund të përcaktojë (menjëherë përpara ose në çdo kohë pas përfundimit të kësaj licence), t'i ofrojë Ministrisë ose të emëruarit të saj këtë informacion mbi biletën që mund t'i kërkohet për të mundësuar pagesat e çmimeve për mbajtësit e biletës fituese.

Për shmangien e dyshimit, është rënë shprehimisht dakord që Ministria të mbajë garancinë edhe pas datës së përfundimit derisa i licencuari të ketë përmbushur detyrimet sipas nenit 25.2. Kur i licencuari të ketë përmbushur këto detyrime, atëherë Ministria brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike i kthen garancinë të licencuarit, përndryshe ajo do të konfiskohet në favor të Ministrisë deri në masën e shumave që detyrohet. Në rastin e fundit, i licencuari do të mbetet përgjegjës për çdo shumë që sipas nenit 25.2 tejkalon vlerën e garancisë.

25.3 Në rast përfundimi të marrëveshjes sipas nenit 25.1 germa "b", do të zbatohen si më poshtë:

a) Garancia do të konfiskohet në favor të Ministrisë; dhe

b) I licencuari, sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë të arsyeshme, pas datës së përfundimit:

i) do t'i transferojë pajisjet Ministrisë ose palëve të tjera që mund t'i caktojë Ministria, me një çmim të arsyeshëm tregu që do të bihet dakord mes palëve; dhe

ii) do të japë kundrejt një tarife të arsyeshme të tregut, Ministrisë ose palëve të tjera që mund t'i caktojë Ministria, licencat e përdorimit të programeve kompjuterike; dhe

iii) T'i sigurojë trajnim Ministrisë ose palëve të tjera që mund t'i caktojë Ministria trajnim, të nevojshëm për Ministrinë apo ndonjë palë tjetër të caktuar nga Ministria, të vazhdojë ushtrimin e lotarisë kombëtare.

Në rast se palët nuk arrijnë një marrëveshje për çmimin dhe pagesën sipas kësaj pike, atëherë do t'i referohen drejtpërdrejt arbitrazhit sipas nenit 29.4, pa pasur nevojë për një përshkallëzim të brendshëm apo ndërmjetësim të mundshëm.

Për qëllimet e këtij neni, ministria nuk do të ketë të drejtë t'i japë në mënyrë të drejtpërdrejtë ushtrimin e lotarisë kombëtare ndonjë pale të tretë që është një konkurrent i drejtpërdrejtë i të licencuarit ose i Oesterreichische Lotterien GmbH dhe Casinos Austria AG, përveç rastit kur një palë e tillë ka qenë e përzgjedhur përmes një procesi konkurrues (p.sh. tender, ose procedurë garuese).

25.4 Në rast përfundimi të kontratës, në përputhje me nenin 25.1 germa "c", Ministria, brenda 3 (tre) muajve kalendarikë nga data e përfundimit:

a) do të rimbursojë të licencuarin me shumën e plotë, të paguar për licencën; dhe

b) do të rimbursojë të licencuarin për të gjitha investimet (duke marrë në konsideratë vitin kur ka ndodhur përfundimi dhe performancën financiare të të licencuarit) dhe shpenzimet e dokumentuara që ka bërë për krijimin, prodhimin, ofrimin, ushtrimin, qarkullimin, promovimin dhe menaxhimin e lojërave të lotarisë kombëtare; dhe

c) ta mbajë të pacenuar të licencuarin nga çdo humbje të fitimit që mund t'i vijë Republikës së Shqipërisë dhe/ose Ministrisë prej një përfundimi të tillë; dhe

d) kthejë garancinë të licencuarit brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarikë.

25.5 Çdo përfundim i kësaj marrëveshjeje ose licence nuk do të ndikojë në të drejtat ose detyrimet e akumuluar të secilës palë.

25.6 Nenet 25 dhe 24 (konfidencialiteti), 28 (ligji rregullues), 29 (zgjidhja e mosmarrëveshjeve), 30 (njoftimet), 31 (mosheqja dorë), 33 (të drejtat e palës së tretë) dhe çdo dispozitë në fuqi e kësaj marrëveshjeje ose licence, që shprehimisht ose që nënkuptohet të jetë në fuqi në ose pas përfundimit të kontratës, do të vazhdojë të jetë në fuqi dhe pas çdo përfundimi.

26. Përfundimi i kalimit (tranzicionit) të kontratës

26.1 Nëse të licencuarit nuk do t'i jepet licenca për të zhvilluar lotarinë kombëtare pas skadimit të licencës ose zgjatjes së saj, atëherë i licencuari e kupton dhe pajtohet me faktin që Ministria mund të përdorë 6 muajt e fundit të afatit të kësaj licence për kalimin (kalimin) e sistemit, ose sistemeve qendrore të lojërave, të rrjetit të lotarisë dhe shitësve me pakicë (periudha e kalimit), duke rënë dakord se të gjitha të ardhurat e krijuara nga shitja e biletave dhe produkteve të tjera do të vazhdojnë t'i paguhet të licencuarit gjatë kohëzgjatjes së kësaj licence ose zgjatjes së saj, pavarësisht nëse ndonjë subjekt tjetër (i licencuari i ardhshëm) është duke ofruar mallra dhe/ose shërbime për kryerjen e ndonjë veprimtarie për

ose në lidhje me kalimin. Ministria do të jetë përgjegjëse e vetme për identifikimin e të gjitha aktiviteteve duke përfshirë (dhe kohën) tranzitimin gjatë periudhës së kalimit. Gjatë periudhës së kalimit, i licencuari do të bashkëpunojë në mirëbesim në kalimin e sipërpërmendur. Nëse Ministria udhëzon kështu një bashkëpunim i tillë mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në veprimet e mëposhtme:

a) Dhënien në mënyrë të arsyeshme të të gjitha ekstrakteve të bazave të të dhënave të nevojshme të të licencuarit për të siguruar vazhdueshmërinë e pagesës së çmimeve;

b) Të japë të gjitha të dhënat e nevojshme për t'i mundësuar të licencuarit të ardhshëm vlerësimin (miratimin apo jo) e biletave;

c) Sipas nenit 26.1e.ii të mëposhtme, do t'i japë Ministrisë informacionin e kërkuar të nevojshëm për vazhdimin e funksionimit të lotarisë kombëtare.

d) Pas përfundimit të periudhës së kalimit bëhet heqja e pajisjeve të të licencuarit, përfshirë këtu pajisjet, *hardware*-t dhe *software*-t nga ambientet e shitësve me pakicë;

me kusht që:

e) Për qëllimet e kalimit të licencuarit nuk do t'i kërkohej të japë:

i) *Hardware*, pajisje, mallra dhe/ose *software* në pronësi të të licencuarit ose nënkontraktuesve ose furnizuesve të kësaj të të licencuarit; ose

ii) (sipas licencës, ose ndryshe) të drejtat e pronësisë intelektuale ose informacion konfidencial mbi të licencuarin, ose nënkontraktorët ose furnizuesit e tij.

f) Bashkëpunimi i të licencuarit në përgjithësi do të jetë në kuadër të veprimeve të përshkruara në nenin 26.1 dhe nuk duhet të kalojë 200 orë pune në muaj gjatë periudhës së konvertimit;

g) Punonjësit e kualifikuar dhe me përvojë mjaftueshëm të të licencuarit do të vihen në dispozicion nga i licencuari për qëllimet e një bashkëpunimi të tillë;

h) Pavarësisht nga çdo gjë në kundërshtim me nenet 19, 21, 25 dhe/ose nenin 26.1:

i) Një konvertim dhe/ose bashkëpunim i tillë nuk duhet të ndërhyjë padrejtësisht në biznesin e të licencuarit, dhe/ose proceset e punës dhe nuk duhet t'i shkaktojnë të licencuarit asnjë lloj dëmi financiar dhe ose asnjë ndikim të ndonjë lloji.

ii) I licencuari nuk do të jetë përgjegjës në asnjë lloj mënyre për ndonjë dështim për të përmbushur licencën dhe/ose aktin, në rast se këto dështime mund të lindin direkt ose indirekt nga një konvertim dhe/ose bashkëpunim i tillë.

Në këtë nen asgjë nuk nënkupton se nuk do të ketë lidhje *on-line* midis sistemit të të licencuarit dhe sistemit të të licencuarit pasardhës.

26.2 Çdo dispozitë e kësaj licence, e cila shprehimisht vendos një detyrim për t'u kryer, ose një të drejtë që duhet të ushtrohet pas përfundimit, skadimit ose revokimit të kësaj licence, do t'i mbijetojë skadimit, përfundimit ose revokimit dhe për këtë qëllim kjo dispozitë e tillë do të jetë e ndashme nga kjo licencë.

27. Pajtueshmëria me rregulloren

I licencuari në çdo kohë duhet të sigurojë që krijimi, prodhimi, ofertimi, ushtrimi, qarkullimi, promovimi dhe menaxhimi i lotarisë kombëtare, si dhe ushtrimi i të gjitha të drejtave dhe kryerja e të gjitha detyrave, do të kryhen në përputhje me kushtet e kësaj marrëveshjeje dhe aktit.

28. Legjislacioni i zbatueshëm

Kjo marrëveshje do të rregullohet dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet bazë të Republikës së Shqipërisë.

29. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët bien dakord që të përdorin vullnetin e tyre të mirë për të zgjidhur çdo pretendim, kundërshti ose mosmarrëveshje (mosmarrëveshje), që dalin nga ose në lidhje me këtë marrëveshje.

29.2 Shkallëzimi i brendshëm. Para fillimit të procedurës formale, Palët duhet pikë së pari të përpiqen në mënyrë jo formale të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre. Pas kërkesës me shkrim të një pale, çdo Palë do të emërojë një përfaqësues të caktuar, detyra e të cilit do të jetë takimi me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Përfaqësuesit e caktuar do të takohen sa here që Palët në mënyrë të arsyeshme mendojnë se është e nevojshme në lidhje me gjetjen e një zgjidhjeje. Përfaqësuesit do ta diskutojnë mosmarrëveshjen (duke përfshirë këtu punonjësit e një nivelit të lartë të secilës Palë) dhe do të përpiqen

ta zgjidhin mosmarrëveshjen pa pasur nevojë për fillimin e ndonjë procedimi formal. Gjatë kohës së diskutimeve, të gjitha kërkesat e arsyeshme të bëra nga një Palë për Palën tjetër për informacion jo të privilegjuar, lidhur në mënyrë të arsyeshme me mosmarrëveshjen dhe me këtë marrëveshje, do të respektohen në mënyrë që secila palë të mund të këshillohet plotësisht mbi pozicionin e palës tjetër në lidhje me mosmarrëveshjen. Format i specifik për diskutim do t'u lihet në dorë përfaqësuesve të caktuar. Në rast se palët dështojnë në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje përmes diskutimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike pas fillimit të diskutimeve (ose në qoftë se një nga Palët refuzon të marrë pjesë në përshkallëzimin e brendshëm), Palët mund të bien dakord, para fillimit të procedurave të arbitrazhit formal, që ata ta zgjidhin mosmarrëveshjen me ndërmjetësim.

29.3 Ndërmjetësimi opsional. Në rast se Palët dështojnë në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje përmes përshkallëzimit të brendshëm, por kanë rënë dakord për ndërmjetësim, Palët do ta paraqesin çështjen për fillimin e procedurave të zgjidhjes së marrëveshjes me ndërmjetësim. Palët mund të bien dakord mbi një ndërmjetës të vetëm ose një panel ndërmjetësish. Kjo gjë do të përcaktojë edhe rregullat e ndërmjetësimit. Palët do të marrin pjesë në ndërmjetësim në mirëbesim. Në rast se mosmarrëveshja nuk është zgjidhur me ndërmjetësim brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike pas marrëveshjes për ndërmjetësim, brenda një periudhe tjetër për të cilën Palët mund të bien dakord me shkrim, ndërmjetësimi të konsiderohet i dështuar. Çdo Palë do t'i përballojë shpenzimet e veta të kryera për këtë ndërmjetësim, duke përfshirë tarifat dhe shpenzimet e avokatëve të tyre. Kostot e ndërmjetësimit, duke përfshirë tarifat e ndërmjetësuesit dhe shpenzimet, do të ndahen në mënyrë të barabartë nga Palët.

29.4 Arbitrazhi. Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet që më parë me anë të përshkallëzimit të brendshëm ose ndërmjetësimit fakultativ, të gjitha mosmarrëveshjet që dalin nga ose në lidhje me këtë marrëveshje do të zgjidhen përfundimisht sipas rregullave të arbitrazhit të dhomës ndërkombëtare të tregtisë nga tre arbitrat e emëruar në përputhje me këto rregulla. Vendi i arbitrazhit do të jetë Zyrihu, Zvicër. Gjuha që do të përdoret në procedurat e arbitrazhit do të jetë anglishtja. Ky nen për arbitrazhin do të qeveriset dhe do të interpretohet në përputhje me ligjin zviceran, duke përfshirë konfliktin e ligjeve.

29.5 Neni i arbitrazhit përbën një miratim të parevokueshëm nga Palët për çdo procedurë në drejtim të tyre dhe asnjë palë nuk do të ketë të drejtë të tërhiqet ose të pretendojë se nuk është e detyruar nga kjo pikë.

29.6 Kjo pikë është e mëvetësishme nga pjesa tjetër e kësaj Marrëveshjeje dhe do të mbetet në fuqi edhe në qoftë se kjo marrëveshje skadon ose përfundon për çfarëdo arsye.

29.7 Pavarësisht nga ndonjë kundërshtim në lidhje me këtë marrëveshje, nëse do të lindë ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet Palëve gjatë rrjedhës së kësaj marrëveshjeje, Palët do të vazhdojnë të kryejnë detyrimet e tyre përkatëse në bazë të kësaj marrëveshjeje deri në dhënien e vendimit përfundimtar të detyrueshme të arbitrazhit.

30. Njoftimet

30.1 Palët do të japin çdo njoftim sipas ose në lidhje me këtë marrëveshje, vetëm me shkrim. Njoftimi do të bëhet duke e shpërndarë dorazi ose duke e dërguar me postë të regjistruar, në adresën e përcaktuar më poshtë, dhe në çdo rast e shënuar në vëmendjen të palës përkatëse. Çdo njoftim, i shpërndarë në dy mënyrat e mësipërme, do të konsiderohet si i dhënë rregullisht:

a) Në rastin e përcjelljes dorazi, kur ky dorëzim ndodh pas orës 18:00 të një dite pune ose në çdo moment të një dite që nuk është ditë pune, shërbimi do të konsiderohet se është kryer në orë 09:00 të ditës së nesërme;

b) Në rast se shërbimi është kryer me anë të postës së regjistruar, në orën 09:00 të ditës së dytë të punës pas datës së postimit, do të konsiderohet përfundimisht që njoftimi është kryer.

30.2 Adresat e Palëve janë si më poshtë:

Republika e Shqipërisë:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 4
Tiranë, Republika e Shqipërisë

I licencuari:
OLG Project sh.p.k.,
NIPT L22119005R,
Rruga "Murat Toptani",
Eurocol Centre,

30.3 Secila palë do ta njoftojë menjëherë palën tjetër të kësaj marrëveshjeje në rast ndryshimi të emrit dhe adresës së saj.

31. Heqje dorë

Asnjë dështim ose vonesë nga secila palë në ushtrimin e ndonjë të drejte ose kompetence nuk mund të veprojë si heqje dorë, dhe as ushtrimi i pjesshëm apo i vetëm i një të drejte ose fuqie të tillë, as braktisja ose mosndjekja e hapave për t'i zbatuar këto të drejta apo kompetenca nuk do të pengojë ushtrimin e mëtejshëm ose ushtrimin e një të drejte apo kompetence të tillë.

32. Ndashmëria

Nëse ndonjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje konsiderohet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, kësaj dispozite nuk do t'i jepet asnjë efekt, do të konsiderohet si e papërfshirë në këtë Marrëveshje, por nuk shfuqizon dispozitat e tjera të saj. Dispozita e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme do të zëvendësohet nga një dispozitë e përshtatshme dhe e barabartë ligjore, e vlefshme dhe e zbatueshme dhe sa më e afërt me synimin dhe qëllimin e dispozitës së paligjshme, të pavlefshme ose të pazbatueshme. Nëse kjo marrëveshje përmban ndonjë të metë, do të zbatohet e njëjta procedurë.

33. Të drejtat e palës së tretë

Kjo marrëveshje është lidhur vetëm mes dy palëve dhe mund të zbatohet vetëm nga Republika e Shqipërisë dhe nga i licencuari. Nga kjo marrëveshje dhe licencë nuk mund të krijohet asnjë e drejtë ose shkak për veprim për ose në llogari të një palë të tretë, përfshirë punonjësit, agjentët, përfaqësuesit, kontraktorët, furnizuesit ose konsumatorët e një Pale ose ndonjë entiteti tjetër të palës së tretë. Një person i cili nuk është palë në këtë marrëveshje nuk gëzon asnjë të drejtë sipas kësaj marrëveshjeje dhe licence.

34. Variante të marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim dhe të jetë e nënshkruar nga të dyja Palët. Kjo kërkesë vlen edhe për këtë pikë.

35. Marrëveshja e plotë

Kjo marrëveshje përbën marrëveshjen e plotë midis palëve që kanë të bëjnë me objektin e kësaj marrëveshjeje. Nuk ka kushte, garanci, përfaqësime ose marrëveshje të tjera mes palëve në lidhje me lëndën e kësaj marrëveshjeje (me gojë ose me shkrim, të shprehur, nënkuptuar ose në formë statusore), përveç asaj që është përcaktuar në mënyrë specifike në këtë marrëveshje.

36. Modifikimet

Në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, Republika e Shqipërisë dhe i licencuari gëzojnë të drejtën që në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë dhe me anë të një marrëveshjeje me shkrim ta ndryshojnë këtë marrëveshje.

37. Kopjet e njëjta

Kjo marrëveshje mund të ekzekutohet me anë të homologëve (kopjeve të njëjta), secila prej të cilëve do të përbëjë një origjinal dhe të gjithë së bashku do të përbëjnë një instrument të vetëm.

38. Gjuha

Gjuha e komunikimit do të jetë gjuha shqipe dhe kur të jetë e nevojshme, gjuha angleze.

Kjo Marrëveshje është hartuar në anglisht dhe shqip. Në rast të ndonjë konflikti midis këtyre versioneve, do të ketë përparësi versioni në gjuhën angleze.

Tiranë, më 17 dhjetor 2012

Emri: Ridvan Bode
Pozicioni: Ministër i Financave

Emri: Peter Simoner
Pozicioni: Administrator